**VENDIM**
**Nr. 39, datë 19.1.2022**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE, ME SHKËMBIM NOTASH, TË MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË, MBI NJOHJEN E NDËRSJELLË TË LEJEVE TË DREJTIMIT, ME QËLLIM KONVERTIMI, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 209, DATË 29.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim notash, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, mbi njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit me qëllim konvertimi, miratuar me vendimin nr. 209, datë 29.3.2021, të Këshillit të Ministrave, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

AMBASADA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
ROMË

AMBASCIATA DELLA REPUBBLICA D'ALBANIA
ROMA

## NOTË VERBALE

Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Romë i paraqet komplimentet e saj Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë dhe ka nderin t'i referohet notës nr. 3151/148770, datë 19.10.2021, të kësaj Ministrie, e cila citon si më poshtë vijon:

"Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë i paraqet komplimentet e saj Ambasadës së Republikës së Shqipërisë dhe ka nderin t'i referohet Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për njohjen reciproke të lejeve të drejtimit të mjetit, me qëllim konvertimin, kryer në Tiranë, më 17 mars 2021.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, në emër të Qeverisë Italiane, nën dritën e nevojës për të harmonizuar marrëveshjen e lartpërmendur, për çfarë përcaktohet nga rregullorja (BE) 2016/679, e datës 27 prill 2016, në çështjen e mbrojtjes së të dhënave personale, siç është paraqitur në notën verbale të kësaj Ministrie nr. 105622, të datës 26 korrik 2021, kam nderin të propozojë ndryshimet vijuese në tekstin e Marrëveshjes, konform asaj çfarë është vendosur nga neni 13, paragrafi 2; më saktësisht propozohet futja e një paragrafi të ri 2 dhe e një paragrafi të ri 3 tek teksti fillestar i nenit 11 të Marrëveshjes në fjalë, me përmbajtje si në vijim:

2. *Palët angazhohen të konfirmojnë trajtimin e të dhënave personale të shkëmbyera në zbatim të marrëveshjes në fjalë në klauzolat e pranishme të dokumentit bashkëngjitur që ka emërtimin "Rregullatori i transferimit të të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente", i cili njësoj si Marrëveshja në fjalë, është ligjërisht detyrues.*

*3. Shkëmbimeve të informacioneve, sipas neneve 8 dhe 9, i bashkëngjitet autorizimi i trajtimit të të dhënave personale, përfshirë deklaratën e leximit të informacionit mbi trajtimin e të dhënave, ofruar nga autoritetet kompetente, dhe të firmosur ashtu siç duhet nga subjekti që kërkon konvertimin e lejes së drejtimit të mjetit që zotëron.*

*Bashkëngjitur:*

*1. Rregullore e transferimit të të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente të referuara në marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për çështjen e njohjes reciproke të lejeve të drejtimit për qëllime konvertimi, nënshkruar në Tiranë, më 17 mars 2021, dhe ndryshimet pasuese.*

_____

**Ministero degli Affari Esteri**
**DG UE/Unita Balcani**
**Roma**

Gjithashtu, Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar, në emër të Qeverisë Italiane, ka nderin të propozojë që dokumenti bashkëngjitur i emërtuar "Rregullatori i transferimit të të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente", të jetë pjesë përbërëse e Marrëveshjes së lartpërmendur.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar, në emër të Qeverisë Italiane, ka nderin të propozojë që nota në fjalë dhe nota e përgjigjes të përbëjnë një amendament të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për njohjen reciproke të lejes së drejtimit të mjetit, me qëllim konvertimin, kryer në Tiranë, më 17 mars 2021, e cila do të hyjë në fuqi sipas procedurave të parashikuara nga neni 13, paragrafi 2, i Marrëveshjes së mësipërme.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar, në pritje të një përgjigjeje pozitive, merr shkas për t'i shprehur Ambasadës së Republikës së Shqipërisë konsideratën e saj më të lartë."

dhe të konfirmojë në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për sa është propozuar dhe bie dakord që kjo notë dhe nota nr. 3151/148770, datë 19.10.2021, do të përbëjnë Marrëveshjen Ndryshuese të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane mbi njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit, me qëllim konvertimi, nënshkruar më 17 mars 2021, e cila do të hyjë në fuqi, sipas parashikimeve të nenit 13, paragrafi 2, të Marrëveshjes bazë.

Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Romë përfiton edhe njëherë nga rasti për t'i përsëritur Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë sigurimet e konsideratës së saj më të lartë.

***Romë, më 13 dhjetor 2021***

*Bashkëngjitur:*

*1. Rregullore e transferimit të të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente të referuara në marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për çështjen e njohjes reciproke të lejeve të drejtimit për qëllime konvertimi, nënshkruar në Tiranë, më 17 mars 2021, dhe ndryshimet pasuese.*

RREGULLORE E TRANSFERIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE NDËRMJET AUTORITETEVE KOMPETENTE SIPAS MARRVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR NJOHJEN RECIPROKE TË LEJEVE TË DREJTIMIT TË MJETIT, ME QËLLIM KONVERTIMIN, NËNSHKRUAR NË TIRANË, MË 17 MARS 2021, DHE NDRYSHIMEVE PASUESE

Duke pasur parasysh nenin 46(2)(a) të Rregullores (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të 27 prillit 2016, në lidhje me mbrojtjen e personave fizikë për sa i përket trajtimit të të dhënave personale, si dhe qarkullimit të lirë të të tilla të dhënave dhe që shfuqizon direktivën 95/46/KE (rregullorja e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave) dhe në referim të neneve 8 dhe 9 dhe të kreut II, "Përpunimi i të dhënave personale", të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar;

Çdo "autoritet kompetent" i një Pale (në vijim "autoriteti"), sipas parathënieve në Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për njohjen reciproke të lejeve të drejtimit të mjetit, me qëllim konvertimin, kryer në Tiranë, më 17 mars 2021, dhe ndryshimet vijuese (në vijim "Marrëveshja"), do të aplikojë garancitë e specifikuara në klauzolat e pranishme në dokumentin në fjalë për transferimin e të dhënave personale nga njëri autoritet kompetent i Palës tjetër.

Të tilla garanci janë të detyrueshme për Palët dhe mbivendosen në rast detyrimesh konfliktuale ekzistuese në rregulloret/urdhrat përkatës/kuadrin ligjor përkatës.

**I. Përkufizime**

Për qëllim të klauzolave në fjalë, kuptohet për:

**a) "të dhëna personale"**, çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar apo të paidentifikuar ("i interesuari") për qëllimet e Marrëveshjes. Konsiderohet i identifikueshëm personi fizik që mund të identifikohet, drejtpërsëdrejti apo jo drejtpërsëdrejti, duke iu referuar veçanërisht një identifikuesi si një emër, numër identifikimi, të dhëna për vendndodhjen, një identifikues në rrjet apo një prej apo më shumë elementeve karakteristike të identitetit të tij fizik, fiziologjik, gjenetik, psiqik, ekonomik, kulturor apo shoqëror;

**b) "të dhëna të veçanta"**, të dhëna që tregojnë origjinën racore apo etnike, opinionet politike, bindjet fetare apo filozofike, përkatësia në sindikatë, të dhëna të përgjithshme apo biometrike të kuptuara si të tilla për të identifikuar në mënyrë unike një person fizik, si dhe të dhënat lidhur me shëndetin, jetën seksuale apo orientimin seksual të personit;

**c) "të dhëna penale"**, të dhëna personale në lidhje më dënimet penale dhe veprat penale apo masat e sigurisë lidhur me to;

e) **të dhëna të zakonshme",** të dhëna personale që nuk janë as të veçanta dhe as penale;

f) **"përpunimi",** çdo veprim apo tërësia e veprimeve të kryera mbi të dhënat personale, me apo pa ndihmën e proceseve të automatizuara, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja apo modifikimi, nxjerrja, konsultimi, përdorimi, komunikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja apo çdo formë tjetër e vënë në dispozicion, krahasimi apo ndërlidhja, kufizimi, fshirja apo shkatërrimi;

g) **"transferimi"**, dërgimi i të dhënave personale nga një autoritet i një Pale tek autoriteti i Palës tjetër;

h) **"komunikime të mëtejshme",** dërgimi i të dhënave personale nga autoriteti marrës te një i tretë i të njëjtit shtet;

i) **"transferimi"**, dërgimi i të dhënave personale nga një autoritet marrës te një i tretë në një shtet të ndryshëm nga ai i Palëve;

j) **"shkelje e të dhënave personale"**, shkelja e sigurisë, që sjell aksidentalisht apo në mënyrë të paligjshme shkatërrimin, humbjen, ndryshimin, përhapjen e paautorizuar apo aksesimin tek të dhënat personale të përcjella, të ruajtura apo, gjithsesi, të trajtuara;

k) "kërkesat e ligjit të aplikueshëm/zbatueshëm", kuadri rregullator vendës në fuqi i aplikuar/zbatuar në çdo institucion të secilës Palë, përfshi këtu dhe rregulloren mbi mbrojtjen e të dhënave personale;

l) **"sekreti zyrtar"**, detyrimi i përgjithshëm ligjor, në fuqi për të dyja institucionet, për të mos përhapur informacione jopublike të marra në cilësinë e ushtrimit të funksioneve përkatëse institucionale;

m) **"të drejtat e të interesuarve":**

**i. "e drejta për të marrë informacione"**, e drejta e një të interesuari për të marrë informacione për trajtimin e të dhënave personale, që i përkasin në formë konçize, transparente, të kuptueshme apo lehtësisht të aksesueshme;

**ii. "e drejta e aksesit",** e drejta e një të interesuari për të marrë konfirmim që është ose jo në vijim të një trajtimi të dhënash, që i përkasin atij dhe në rast pozitiv të përftojë aksesin tek të dhënat e veta personale dhe të karakteristikave të trajtimit në vijim;

**iii. "e drejta e ndryshimit",** e drejta e një të interesuari të mundësojë ndryshimin apo integrimin e të dhënave personale të pasakta, që i përkasin, pa vonesa të pajustifikuara;

**iv. "e drejta e fshirjes",** e drejta e një të interesuari të mundësojë fshirjen e të dhënave personale, kur të dhënat janë mbledhur apo trajtuar në mënyrë të paligjshme kundrejt klauzolave në fjalë dhe kritereve ligjore në fuqi;

**v. "e drejta për të kundërshtuar",** e drejta e të interesuarit për të kundërshtuar në çdo moment, për arsye lidhur me gjendjen e tij të veçantë, trajtimin e të dhënave personale që i përkasin, duke përjashtuar rastin kur ekzistojnë arsye legjitime bindëse për trajtimin që mbivendosen mbi interesat e shtruar nga i interesuari, ndër të cilat sigurimi, ushtrimi apo mbrojtja e një të drejte në aspektin gjyqësor;

**vi. "e drejta e kufizimit të trajtimit"**, e drejta e të interesuarit në kufizimin e trajtimit të të dhënave personale kur këto janë të pasakta, kur trajtimi është i paligjshëm, kur një institucion nuk ka më nevojë për të dhënat personale kundrejt qëllimeve për të cilat ishin mbledhur apo i interesuari është në pritje të vlerësimit të një kërkese të tij kundërshtuese;

**vii. "e drejta për të mos iu nënshtruar vendimeve të automatizuara"**, e drejta e një të interesuari që të mos i nënshtrohet një vendimi të bazuar vetëm mbi trajtimin e automatizuar, që prodhon efekte ligjore që i përkasin apo që influencojnë në mënyrë analoge, domethënëse mbi vetë personin.

Duke mos u futur në qëllimet e Marrëveshjes, është i ndaluar shkëmbimi i "**të dhënave penale",** si dhe **"profilizimi"** i të interesuarit, nënkuptuar si çdo trajtim i automatizuar i të dhënave personale, me qëllim vlerësimin e disa aspekteve personale të kërkuesve për konvertim lejeje drejtimi mjeti.

Për qëllimet e Marrëveshjes është, gjithashtu, i përjashtuar përdorimi i procedurave të automatizuara.

**II. Fusha e aplikimit**

Klauzolat në fjalë u aplikohen mbajtësve të lejeve të drejtimit të mjetit, sipas nenit 1 të Marrëveshjes, që kërkojnë konvertimin e lejes së drejtimit të mjetit lëshuar nga njëra Palë në një leje të lëshuar nga Pala tjetër. Para lëshimit të kësaj lejeje drejtimi mjeti, të interesuarit mund të heqin dorë në çdo moment nga konsensusi për trajtimin e të dhënave personale me rrjedhojë anulimin e procedurës së konvertimit.

Për sigurimin e së drejtës dhe ofrimin e shërbimit do të trajtohen të dhënat personale të të interesuarve, si në vijim:

1. Të dhëna të zakonshme: gjeneralitetet (emri dhe mbiemri, kombësia, vendi dhe data e lindjes, adresa) të dhënat e kontaktit (telefoni, *email)* të dhëna në lidhje me lejen e drejtimit që zotëron për të cilën kërkohet konvertimi – në vijim leja e drejtimit – (numri, data e testimit, data e lëshimit dhe e skadimit, duke iu referuar çdo kategorie, prani e pengesave të rastit), mënyra e realizimit të marrjes së lejes së drejtimit të mjetit (provime apo konvertimi i lejes së drejtimit të

mjetit të lëshuar nga një shtet tjetër, duke dalluar shtetin përkatës), të dhëna të tjera të nevojshme për konvertimin e lejeve të drejtimit të mjetit, atëherë kur ka të pranishme anomali në lidhje me vlefshmërinë, origjinalitetin dhe të dhënat që ajo mbart në të.

2. Të dhëna të veçanta: përshkrime të rastit në lidhje me lejen e drejtimit të mjetit dhe të formalizuara në formën e kodeve, të lidhura me sigurimin e kritereve të aftësisë psikofizike të drejtimit të mjetit.

**III. Garancitë për mbrojtjen e të dhënave personale**

**1. Kufizimi i qëllimeve**

Të dhënat personale do t'u transferohen autoriteteve, me synimin e vetëm për të ndjekur qëllimet e treguara në pikën II. Autoritetet nuk do të kryejnë komunikime apo transferime të mëtejshme të të dhënave personale, për qëllime të ndryshme nga ato të treguara më lart, duke u kujdesur të përftojnë garancitë e duhura, me qëllim që trajtimet e mëtejshme të të dhënave të jenë të kufizuara për këto qëllime, duke pasur parasysh për sa më sipër treguar në pikën III.6

**2. Proporcionaliteti dhe cilësia e të dhënave**

Autoriteti transferues do të dërgojë ekskluzivisht të dhëna personale të duhura, relevante dhe të kufizuara, për sa është e nevojshme, kundrejt qëllimeve për të cilat janë transferuar dhe më tutje trajtuar. Transferimi i të dhënave të veçanta pranohet vetëm nëse rezulton jashtëzakonisht e domosdoshme për realizmin e qëllimeve të Marrëveshjes.

Autoriteti transferues do të sigurojë, për aq sa është në dijeni, që të dhënat personale që transferon janë të sakta dhe nëse është e nevojshme të përditësuara. Nëse një autoritet vihet në dijeni të faktit që të dhënat personale që i ka përcjellë një autoriteti tjetër janë të pasakta, do të informojë Institucionin marrës, që do të marrë masa për korrigjimin e rastit.

**3. Transparenca**

Në bazë të nenit 11 të Marrëveshjes, secili nga autoritetet do t'u japë të interesuarve një dokument informativ specifik mbi masat që do të merren në rregulloren përkatëse për të garantuar konformitetin e trajtimit të të dhënave personale me klauzolat e këtij dokumenti bashkëlidhur, duke iu referuar në veçanti:

a) identitetit dhe të dhënat e kontaktit të Mbajtësit të trajtimit dhe aty ku është e pranishme e përgjegjësit të mbrojtjes së të dhënave;

b) qëllimet, baza ligjore dhe modalitetet e trajtimit të të dhënave personale, përfshi këtu periudhën e ruajtjes së tyre;

c) marrësit, të cilëve të dhënat e mësipërme mund t'u dërgohen si komunikim apo transferim të mëtejshëm, duke u kujdesur në saktësimin e garancive të parashikuara dhe arsyet e dërgimit;

d) të drejtat e të interesuarve në bazë të klauzolave në fjalë dhe të kritereve të ligjit në fuqi, përfshi këtu edhe mënyrat e ushtrimit të këtyre të drejtave;

e) informacionet mbi vonesat e rastit apo kufizimet e aplikueshme, në lidhje me ushtrimin e të drejtave të tilla;

f) kontaktet për të ngritur një mosmarrëveshje apo për të paraqitur një pretendim.

Secili prej autoriteteve do të shpërndajë informacionet në sitin përkatës, së bashku me Marrëveshjen. Një kopje e këtij dokumenti informativ do të përfshihet në komunikimet individuale të të interesuarve, ashtu si një referim për sitin e lartpërmendur.

**4. Siguria dhe privatësia**

Secili prej autoriteteve do të vërë në zbatim masa teknike dhe organizative të duhura për mbrojtjen e të dhënave të marra nga aksesime rastësore apo të paligjshme, shkatërrimi, humbja, ndryshimi apo përhapja e paautorizuar. Masat e lartpërmendura do të përfshijnë masat e duhura administrative, teknike dhe fizike të sigurisë. Këto masa duhet të përfshijnë dhe klasifikimin e të dhënave personale të zakonshme dhe të veçanta, kufizimin e subjekteve të pranuar që të aksesojnë në të dhënat e lartpërmendura, arkivimin e sigurt të tyre në funksion të tipologjisë së tyre dhe të përshtatjes së politikave, që kanë si qëllim të sigurojnë që të dhënat personale të mbahen të sigurta dhe private, duke përdorur edhe teknika të pseudonimeve dhe shifrimeve. Për

menaxhimin e të dhënave të veçanta duhet të merren masa sa më të rrepta sigurie, duke parashikuar ndër të tjera edhe akses më të madh selektimi dhe formimin e specializuar të punonjësve.

Atëherë kur një autoritet marrës vihet në dijeni të një shkeljeje të të dhënave personale, do të informojë brenda 48 orësh autoritetin transferues dhe do të marrë masat më të arsyeshme dhe të duhura për të gjetur zgjidhjen dhe për të minimizuar efektet e mundshme negative për të interesuarit, përfshi këtu edhe komunikimin e kësaj gjëje të interesuarve, pa asnjë vonesë të pajustifikuar, nga momenti i shkeljes, atëherë kur kjo mund të sjellë një rrezik të lartë për të drejtat e tyre dhe lirinë e tyre.

**5. Mënyrat për ushtrimin e të drejtave**

Secili autoritet do të marrë masat e duhura derisa me kërkesë të interesuarit mund të:

1. Konfirmojë nëse trajton apo jo të dhëna personale që i përkasin dhe rast konfirmimi pozitiv, të japë aksesin e këtyre të dhënave, si dhe të japë informacione për transferimin e tyre, përfshi këtu dhe informacione për qëllimet e trajtimit, kategoritë e të dhënave të konsideruara, origjina dhe marrësit e të dhënave, periudha e parashikuar e ruajtjes dhe mundësitë e padisë dhe të kundërshtimit;

2. Identifikojë të gjitha të dhënat personale të kërkuesit që i janë transferuar autoritetit tjetër në bazë të klauzolave;

3. Dhënia e informacioneve të përgjithshme edhe në sitin përkatës, në lidhje me garancitë që aplikohen, në lidhje me transferimet te një autoritet tjetër.

Secili autoritet do t'i japë udhë në mënyrë të arsyetuar dhe në kohën e duhur një kërkese të një të interesuari, në lidhje me ndryshimin, fshirjen, kufizimin e trajtimit apo kundërshtimin e trajtimit të të dhënave personale apo ushtrimin e së drejtës, që mos t'u nënshtrohet vendimeve të automatizuara. Adresat e postës së zakonshme apo elektronike për dërgimin e kërkesave të lartpërmendura duhet t'i tregohen të interesuarve në dokumentin informativ, në bazë të pikës III mbi transparencën. Një autoritet mund të marrë masat e duhura, se si mund të caktojë një tarifë shpenzimesh të arsyeshme për të mbuluar kostot administrative të kërkesës apo të refuzojë t'i japë udhë, nëse kjo rezulton në mënyrë të dukshme e pabazë apo e tepruar.

Të drejtat e të interesuarve mund të kufizohen, në masën e nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike në mbrojtje të objektivave të rëndësishëm të interesit publik, të njohur nga Palët në frymën e reciprocitetit, që i takon bashkëpunimit ndërkombëtar. Hyjnë në këtë kuadër edhe mbrojta e të drejtave dhe e lirive të tjetrit, siguria kombëtare, mbrojtja, parandalimi, hetimi, vërtetimi dhe ndjekja e veprave penale, si dhe kryerja e një funksioni kontrolli, inspektimi dhe rregullimi lidhur me të, edhe herë pas here, i veprimeve ekzekutive dhe mbikëqyrja e autoritetit, operuese, në ushtrimin e detyrave publike, për të cilat është ngarkuar. Kufizimet e mësipërme, të rregullohen me ligj, mund të qëndrojnë derisa të ekzistojë arsyeja për të cilën janë nistuar.

**6. Komunikimi dhe transferimi i mëtejshëm i të dhënave personale**

*6.1 Komunikimi i mëtejshëm i të dhënave personale*

Një autoritet marrës mund të procedojë me komunikimin e mëtejshëm të të dhënave personale te një i tretë vetëm me autorizim paraprak të shkruar nga autoriteti transferues dhe që ky i tretë të japë të njëjtat garanci të parashikuara në klauzolat. Në kërkesën me shkrim, autoriteti marrës duhet të japë informacione të mjaftueshme mbi tipologjinë e të dhënave që ka si qëllim të komunikojë, mbi palën e tretë marrëse, si dhe bazën ligjore, arsyet dhe qëllimet e komunikimit.

Një autoritet marrës mund të vijojë, në rast të jashtëzakonshëm, me komunikimin e të dhënave të mëtejshme te një i tretë, pa autorizimin e autoritetit transferues, vetëm nëse rezulton e nevojshme për të paktën një nga arsyet në vijim:

- mbrojtjen e interesave jetësorë të një të interesuari apo të një personi tjetër fizik;
- vërtetimin, ushtrimin apo mbrojtjen e një të drejte, në kuadrin administrativ apo gjyqësor;

- kryerjen e një hetimi apo procedimi penal ngushtësisht të lidhur me aktivitetin për të cilin të dhënat personale janë transferuar.

Në rastet paraprake, autoriteti marrës do të informojë paraprakisht autoritetin transferues për komunikim e mëtejshëm, duke dhënë elemente mbi të dhënat e kërkuara, organin kërkues, dhe bazën ligjore përkatëse. Atëherë kur informacioni paraprak është në konflikt me një detyrim konfidencialiteti, si në rastin e hetimeve në vijim, autoriteti marrës duhet të informojë autoritetin informues për komunikim e mëtejshëm të kryer, sa më shpejt të jetë e mundshme. Në rastet paraprake, autoriteti transferues duhet të mbajë shënim njoftimet e rastit dhe t'ia komunikojë ato autoritetit të saj të mbikëqyrjes, në bazë të pikës III.8, me kërkesë të saj. Autoriteti marrës do të angazhohet derisa të kryhet komunikimi i mëtejshëm, pa autorizimin paraprak të të dhënave personale të marra në bazë të klauzolave në fjalë, në veçanti duke vlerësuar të gjitha përjashtimet dhe kufizimet e aplikueshme.

*Transferimi i mëtejshëm i të dhënave*

Një autoritet marrës mund të procedojë me komunikimin e mëtejshëm të të dhënave personale te një i tretë vetëm me autorizim paraprak të shkruar nga autoriteti transferues dhe që ky i tretë të japë të njëjtat garanci të parashikuara në klauzolat. Në kërkesën me shkrim, autoriteti marrës duhet të japë informacione të mjaftueshme mbi tipologjinë e të dhënave që ka si qëllim të komunikojë, mbi palën e tretë marrëse, si dhe bazën ligjore, arsyet dhe qëllimet e transferimit të mëtejshëm.

**7. Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave**

Autoritetet do të ruajnë të dhënat personale për kohën e parashikuar nga kriteret e ligjore të aplikueshme, të cilat duhet të parashikojnë një periudhë kohore jo më shumë se ajo e nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike, për qëllimet për të cilat janë trajtuar.

**8. Mbrojtja administrative dhe ligjore**

Nëse i interesuari konsideron që një autoritet nuk ka respektuar garancitë e parashikuara në klauzolat në fjalë apo që të dhënat personale kanë qenë objekt trajtimi i paligjshëm ai ka të drejtën të paraqesë një ankimi te një autoritet mbikëqyrës i pavarur[1] dhe një padi te një autoritet gjyqësor, në përputhje me ligjin në fuqi në juridiksionin në të cilën është kryer shkelja e pretenduar[2]. I interesuari ka, gjithashtu, të drejtën të dëmshpërblehet në rast dëmtimesh të pësuara.

Në rast mosmarrëveshjeje apo pretendimi të paraqitur nga një i interesuar kundrejt autoritetit transferues, autoritetit marrës apo të dyja së bashku autoritetet në lidhje me trajtimin e të dhënave personale të interesuarit, autoritetet duhet të japin informacion reciprok për këto mosmarrëveshje apo pretendime dhe duhet të angazhohen në zgjidhjen e mosmarrëveshjes apo të pretendimit në rrugë miqësore dhe sa më shpejt të jetë e mundur.

Atëherë kur i interesuari ngre një problematikë dhe autoriteti transferues konsideron që autoriteti marrës nuk ka vepruar në përputhje me garancitë e parashikuara në klauzolat në fjalë, autoriteti transferues do të pezullojë transferimin e të dhënave personale autoritetit marrës, deri atëherë kur sa të konsiderojë që kjo e fundit e ka zgjidhur problematikën në mënyrë të kënaqshme. Autoriteti transferues do të informojë për zhvillimet e çështjes të interesuarin dhe autoritetin e saj të mbikëqyrjes.

**Mbikëqyrja**

---

[1] Në Shqipëri Autoriteti i Mbikëqyrjes i Pavarur, në bazë të neneve 29–31, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, aktiviteti i të cilit rregullohet me kreun VIII të këtij ligji. Gjithmonë, duke iu referuar Shqipërisë, autoriteti gjyqësor kompetent, në bazë të neneve 16, 40 të ligjit, është autoriteti gjyqësor i shkallës së parë, që vepron sipas afateve dhe procedurave që rregullojnë gjykimin administrativ.

[2] Në Itali, Autoriteti i Mbikëqyrjes i Pavarur, në bazë të nenit 77 të RGPD (BE) 2016&679, është garantuesi për mbrojtjen e të dhënave personale, aktiviteti i të cilit rregullohet nga nenet 140-bis dhe vijuese të Kodit në Çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale (dekret. legjis. 196/2003 dhe ndryshimet vijuese). Gjithmonë, duke iu referuar Italisë, Autoriteti Gjyqësor kompetent, në bazë të nenit 79 të RGPD-së, është autoriteti gjyqësor i shkallës së parë, siç parashikohet në nenin 152 të Kodit të cituar.

1. Mbikëqyrja e jashtme për aplikimin korrekt të klauzolave në fjalë sigurohet nga autoritetet e mbikëqyrjes të pavarura, të përmendura në pikën III.8

2. Çdo autoritet do të kryejë kontrolle periodike të politikave të veta dhe të procedurave në zbatim të klauzolave në fjalë dhe të efikasitetit të tyre. Përballë një kërkese të arsyetuar nga ana e një autoriteti, autoriteti i thirrur do të kontrollojë sërish politikat e veta dhe procedurat e trajtimit të të dhënave për të vërtetuar dhe për të konfirmuar që garancitë e parashikuara në klauzolat në fjalë kanë qenë zbatuar në mënyrë efikase. Përfundimet e kontrolleve do t'u komunikohen autoriteteve që kanë kërkuar mbikëqyrjen.

3. Atëherë kur autoriteti marrës nuk është në gjendje, për çdo lloj arsye, të zbatojë me efikasitet garancitë e parashikuara në klauzolat në fjalë, do të informojë pa vonesë autoritetin transferues, e në këtë rast, ky autoritet ndërpret përkohësisht transferimin e të dhënave personale autoritetit marrës, derisa kjo e fundit të konfirmojë që është përsëri e aftë të veprojë në përputhje me garancitë e përmendura.

4. Atëherë kur autoriteti transferues konsideron që autoriteti marrës nuk ka vepruar në përputhje me garancitë e parashikuara në klauzolat në fjalë, autoriteti transferues do të pezullojë transferimin e të dhënave personale autoritetit marrës derisa ta konsiderojë që ky i fundit ka zgjidhur çështjen në mënyrë të kënaqshme. Në lidhje me këtë gjë autoriteti transferues do të mbajë të informuar autoritetin e mbikëqyrjes.

**IV. Rishikimi dhe vlefshmëria e klauzolave**

1. Palët mund të konsultohen për të rishikuar afatet e klauzolave në fjalë, në rast ndryshimesh thelbësore në kriteret e ligjit në fuqi. Për rishikimin e klauzolave aplikohet dispozita sipas nenit 13, paragrafi 2, të marrëveshjes.

2. Të gjitha të dhënat personale të transferuara tashmë në bazë të klauzolave në fjalë do të vijojnë të trajtohen, duke aplikuar garancitë e parashikuar aty, edhe pas skadimit të Marrëveshjes apo të denoncimit të tij të kryer në bazë të nenit 13, të marrëveshjes.